



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4 paragrafi 3 dhe nenin 72 të Ligjit 05/L-45 për sigurime (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2016 miratoi

RREGULLORE PËR AKTUARËT E SIGURIMEVE

Neni 1

Fushëveprimi i rregullores

1. Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret si dhe kërkesat, që nevojiten për t'u bërë aktuar i emëruar dhe i aprovuar i sigurimeve, për të vepruar në Kosovë, si dhe raportimet e tjera që kërkohen nga BQK-ja.
2. Aktiviteti i një aktuari të sigurimeve mund të ushtrohet nga personat fizikë ose personat juridikë (aktuarë dhe kompani aktuaristike) të aprovuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (tani e tutje: BQK) sipas dispozitave të kësaj rregullore.
3. Aktuarët e definuar në nenin 2, nuk mund të ushtrojnë operacionet e tyre si aktuar të sigurimeve para se të emërohen nga siguruesi dhe të aprovohen nga BQK-ja.
4. Secili aktuar i sigurimeve do t'i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve të sigurimeve të Kosovës dhe do të mbikëqyret në mënyrë specifike nga BQK-ja.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për sigurimet (më tutje Ligji për sigurimet), ose sipas përkufizimeve në vijim, për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - a) "*Aktuar i sigurimeve*" nënkupton cilindo person që është trajnuar në mënyrë profesionale, i cili ka trajnimin e duhur dhe është i kualifikuar si aktuar apo është i regjistruar si i tillë në një institucion apo institucione profesionale të njohura nga BQK-ja. Aktuari i sigurimeve mund të jetë një person juridik i themeluar me qendër në Republikën e Kosovës për të kryer aktivitete aktuaristike të sigurimeve apo person fizik i cili kryen aktivitete aktuaristike të sigurimeve për siguruesit;
 - b) "*Aktuari i emëruar*" nënkupton aktuarin e kualifikuar që është emëruar nga siguruesi për të kompletuar raportin mbi vlerësimin aktuarial të provizioneve teknike dhe përmbledhjen e opinionit të aktuarit, kalkulimet aktuariale dhe dokumentet e punës;

- c) "*Aktuari i kualifikuar*" nënkupton aktuarin e aprovuar nga BQK-ja.
2. Për qëllime të kësaj rregulloreje, përveçse kur është specifikuar ndryshe me dispozita të veçanta, me termin sigurues nënkuptohet edhe risigurues.

Neni 3

Kërkesat për aprovim të aktuarit

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, vlerësimet e aktuarit që janë subjekt i kësaj rregulloreje mund të kryhen në Kosovë vetëm nga aktuarët e emëruar nga bordi i drejtorëve të siguruesit dhe të aprovuar nga BQK-ja. BQK-ja mund të aprovojë një aktuar që të kryejë vlerësime aktuaristike në Kosovë nëse i plotësojnë të gjitha kriteret në paragrafin 2 të këtij neni.
2. Aktuari duhet të jetë i përshtatshëm dhe i duhur (fit and proper) për të mbajtur pozitën e caktuar të aktuarit për siguruesin bazuar në kriteret si në vijim:
- a) integritet, ndershmëri dhe zotim për përmbushjen e detyrave të tyre;
 - i. kompetencë, aftësi profesionale dhe gjykim të shëndoshë në përmbushjen e detyrave të tyre;
 - ii. pavarësi në mënyrë që të mos kenë ndikim negativ në interesat e siguruesit si rrjedhojë e konfliktit të interesit që mund të shfaqet gjatë kryerjes së detyrës.
 - iii. të ketë kualifikimet profesionale të përcaktuara përmes titullit shkencor aktuarial apo certifikatës të lëshuar nga një universitet ose institucion i njohur profesionale që certifikon përfundimin e suksesshëm të ciklit të plotë të kualifikimeve aktuaristike;
 - b) preferohet të jetë anëtar i ndonjë shoqërie apo organizate aktuariale të njohur ndërkombëtarisht;
 - c) të ketë përvojë në fushën e shkencave aktuariale;
 - d) të ketë njohuri profesionale në legjislacion, etikë dhe praktikat më të mira të tregut të sigurimeve në Kosovë;
 - e) përveç dispozitave të përcaktuara më lartë, BQK-ja vlerëson sjelljen dhe aktivitetet e mëhershme të personit në fjalë, në çështjet profesionale dhe financiare dhe në veçanti do të kontrollojë nëse ka dëshmi të cilat tregojnë se ka qenë ose është:
 - i. i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg;
 - ii. i përfshirë ose i ndërlidhur me ndonjë humbje financiare të shkaktuar nga veprimet e pandershme, të pamatura apo neglizhence, në lidhje me performancën e shërbimeve financiare dhe menaxhimin e kompanive të tjera tregtare;
 - iii. angazhimi në praktikat e biznesit komercial, përfshirë këtu evazionin fiskal, të cilat BQK-ja i konsideron si praktika mashtruese, të papërshtatshme apo kërcënuese në ndonjë mënyrë reflektojnë mungesën e vlerave të personit në performancën e shërbimeve financiare dhe operacionet e tjera biznesore.
 - iv. të jetë i regjistruar në Agjencionin e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (nëse aktuari nuk është në marrëdhënie pune me siguruesin).
 - v. të mos ketë obligime tatimore të papaguara me kohë.
3. Bordi i drejtorëve të secilit sigurues duhet të emërojë një aktuar të aprovuar nga BQK-ja. Ky aktuar do të emërohet nga Bordi i drejtorëve të siguruesit. Siguruesi duhet të njoftojë BQK-në brenda 15 ditësh me shkrim për këtë emërim.

4. BQK-ja mund të caktojë rregulla të tjera në lidhje me kërkesat për trajnim profesional dhe vlerësim të njohurisë teknike, që nevojiten për të kryer detyrat e një aktuari të aprovuar e që këto të jenë në pajtim me kërkesat e shoqatave apo organizatave të njohura ndërkombëtare të aktuarëve.
5. Periudha e vlefshmërisë së aprovimit të BQK-së është tri (3) vite, me të drejtë të ripërtëritjes, pas prezantimit të dëshmive për trajnim të vazhdueshëm profesional, i cili duhet të jetë jo më pak se 30 orë brenda tri viteve.
6. Aktuarët që dëshirojnë të aprovohen ose riaprovohen nga BQK-ja për të kryer vlerësime aktuaristike në Kosovë duhet të dorëzojnë një kërkesë së bashku me dëshminë e pagesës së tarifës së nevojshme, të caktuar nga BQK-ja dhe të dorëzojnë dëshmi që ata i plotësojnë të gjitha kërkesat nga paragrafët 2 dhe 5 të këtij neni.
7. Vendimi i BQK-së për aprovimin ose refuzimin e aprovimit do të justifikohet dhe do të bëhet i ditur me shkrim aktuarit apo siguruesit, i cili ka aplikuar në emër të aktuarit, brenda një (1) muaji nga data e kompletimit të kërkesës dhe dokumentacionit për aprovim si aktuar i autorizuar.

Neni 4

Regjistri i aktuarëve të aprovuar të sigurimeve

BQK-ja do të mbajë një regjister publik në faqen e vet të internetit me të gjithë aktuarët e aprovuar në Kosovë.

Neni 5

Tërheqja e aprovimit të aktuarëve

1. BQK-ja do të tërheq aprovimin e një aktuari të autorizuar në rastet si në vijim:
 - a) BQK-ja ka gjetur se aprovimi është siguruar në bazë të shënimeve qëllimisht të rrejshme;
 - b) aktuari i aprovuar, bën shkelje serioze të ligjit, rregulloreve, instrumenteve të tjera rregullative, rregullave të profesionit të aktuarit dhe kodit të etikës;
2. BQK-ja do të informojë siguruesin, ku aktuari i aprovuar kryen shërbimet aktuaristike, për tërheqjen e aprovimit për atë aktuar.
3. Mbikëqyrja e aktuarëve të aprovuar kryhet nga BQK-ja. Dispozitat e neneve të kësaj rregulloreje, që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e siguruesve do të vlejnjë në mënyrë të përshtatshme edhe për mbikëqyrjen e aktuarëve të aprovuar.
4. BQK-ja mund të suspendojë aprovimin e një aktuari për një periudhë 1 deri 3 vjeçare nëse bëjnë ndonjë shkelje të kësaj rregulloreje, e cila konsiderohet me efekt material nga BQK-ja.
5. BQK-ja mund të aprovojë rregulla shtesë në lidhje me emërimin, largimin dhe çështje të tjera në lidhje me aktuarët e aprovuar.

Neni 6

Ndërrimi i aktuarit

Kur siguruesi apo risiguruesi ka për qëllim të ndërroj aktuarin e vet, duhet të marrë një aprovim paraprak me shkrim nga BQK-ja.

Neni 7

Sigurimi i përgjegjesisë profesionale

Kompanitë aktuaristike gjatë gjithë kohës së ushtrimit të aktivitetit të tyre duhet të kenë sigurim të vlefshëm për përgjegjësi profesionale për të siguruar obligimet e tyre ndaj policëmbajtësve në rast të shkeljes së dispozitave të marrëveshjes së tyre për shërbime, deri në një shumë të caktuar, e cila në ndonjë rast të veçantë të siguruar nuk mund të jetë më e vogël se 500,000 euro, apo në të gjitha rastet e siguruara brenda vitit nuk mund të jetë më e vogël se 1,000,000 euro apo ndonjë shumë tjetër, e cila shihet si e arsyeshme nga BQK-ja.

Neni 8

Raportimi shtesë

1. Kompanitë aktuaristike do të raportojnë në BQK faktet dhe rrethanat si në vijim:
 - a) regjistrimin e çfarëdo ndryshimi në shënimet e tyre që janë të regjistruara në Regjistrin e bizneseve;
 - b) listën e çfarëdo ndryshimi në aksionarët e aktuarit, apo holding kompanitë;
 - c) çfarëdo emërimi ose largimi i anëtarëve të bordit të drejtorëve;
 - d) kohën e caktuar të fillimit të operacioneve, rivendosjen, mbylljen apo ndalimin e përkohshëm të aktivitetit të aktuarit apo çfarëdo ndryshimi tjetër në llojet e aktivitetit të kryera nga aktuari;
 - e) informatat shtesë apo ndryshimet e informatave për personat ose personat apo palët e ndërlidhura dhe ndryshimet e këtyre informatave;
 - f) pasqyrat financiare përfshirë këtu pasqyrat e të ardhurave, bilancin e gjendjes dhe rrjedhën e parave të gatshme nëse kërkohet;
 - g) çfarëdo informate shtesë të cilën BQK-ja e sheh si të rëndësishme.

Neni 9

Deklarata mbi përmbledhjen e opinionit të aktuarit dhe raportit i aktuarit

1. Përmbledhja vjetore e raportit aktuarial se bashku me opinionit e aktuarit siç është referuar në nenet 10, 11 dhe 13 më poshtë do të dorëzohen tek Bordi i drejtorëve të siguruesit, e siguruesi do t'ia ofrojë këtë BQK-së.
2. Bordi i drejtorëve të siguruesit do të ndërmarrë masa për të rregulluar aktivitetin në pajtim me raportin e aktuarit të emëruar siç referohet në nenin 10 dhe nenin 11 të kësaj rregulloreje. Nëse Bordi i drejtorëve të siguruesit dështon në ndërmarrjen e masave të nevojshme në pajtim me raportin e aktuarit, aktuari i emëruar duhet të njoftojë BQK-në menjëherë.
3. BQK-ja mund të caktojë kërkesa shtesë në lidhje me përmbushjen e kritereve të caktuara në këtë nen. Përveç dorëzimit të raportit tremujor dhe vjetor mbi vlerësimin e provizioneve

teknike, siguruesit do të jenë të obliguar që në baza vjetore të dorëzojnë në BQK edhe opinionin e aktuarit mbi vlerësimin edhe adekuatshmërinë e provizioneve teknike për siguruesit.

4. Përmbledhja e opinionit të aktuarit e dorëzuar nga siguruesi të BQK-ja, do të bëhet informatë publike dhe BQK-ja ka autoritetin që të publikojë dokumentin, i cili mund të lexohet në faqen e vet zyrtare të internetit.
5. Dokumentet aktuariale të punës që janë ofruar si mbështetje për deklaratën e opinionit të aktuarit dhe çfarëdo informate tjetër e ofruar nga siguruesi të BQK-ja në lidhje me deklaratën e opinionit të aktuarit të lëshuar sipas këtij neni është konfidenciale; sidoqoftë, asgjë nga ky nen nuk e kufizon autoritetin e BQK-së që të dorëzojë dokumentet të ndonjë organizatë profesionale që disiplinon aktuarët dhe që është e njohur nga BQK-ja, përderisa materiali kërkohet për qëllim të procedimeve profesionale disiplinore dhe kur organizata profesionale ka krijuar procedura të kënaqshme për BQK-në në ruajtjen e konfidencialitetit të dokumenteve.

Neni 10

Sigurimi jojetë – përmbajtja e detajuar e deklaratës të raportit të aktuarit

1. Deklarata e raportit të aktuarit për detyrimet e sigurimit jo-jetë duhet të përmbajë së paku informatat në vijim:
 - a) vlerësimi i tyre nëse siguruesi mban shënime si duhet për kalkulimin e provizioneve teknike;
 - b) tabelat që kanë shënime mbi provizionet teknike, të ndara sipas klasave të sigurimit dhe llojeve të provizioneve teknike të ofruara në legjislacionin aktual për sigurime;
 - c) parimet e përgjithshme dhe metodat e përdorura për vlerësimin e secilës klasë të sigurimit dhe secilës kategori të kontratave të sigurimeve, përfshi referencat specifike për këto si në vijim:
 - i. baza e caktimit të provizioneve për primet e pafituara;
 - ii. baza e caktimit të provizioneve për rrezikun e paskaduar;
 - iii. baza e caktimit të provizioneve për dëmet e papaguara dhe dëmet e ndodhura por jo të raportuara (IBNR);
 - iv. baza e caktimit të provizioneve të tjera teknike;
 - d) nëse ka pasur ndonjë ndryshim të konsideruar në vlerësimet aktuariale dhe / ose metodat nga atë që janë shfrytëzuar më herët, atëherë ky ndryshim duhet të përshkruhet;
 - e) të tregohen rezultate nga testi i adekuatshmërisë së detyrimeve (LAT) sipas klasave të sigurimeve;
 - f) të tregohen rezultatet për ecjen e zhvillimit të dëmeve (Claim Development Run-Off) për një (1) vit dhe për dy (2) vite, sipas klasave të sigurimit.
2. Para se të komentohet për pjesën e risiguruesit në provizionet teknike, aktuari duhet të marrë informata nga menaxhmenti mbi çfarëdo problemi të mbledhjes dhe të shqyrtojë notat e dhëna për risiguruesit nga ndonjë institucion i njohur për notim.
3. Për kontratat e sigurimeve të cilat cedohen te risiguruesi sipas klasave të sigurimit:
 - a) agregati i primeve të paguara nga siguruesi sipas kontratës së risigurimit në vitin e llogaritur me të cilin ndërlihet raporti i aktuarit, nëse është e përshtatshme, dhe shuma agregate e depozituar në datën e vlerësimit sipas çfarëdo marrëveshje për kthimin e depozitës;

- b) pjesa e risigurimi në provizionet teknike që kanë të bëjnë me primet dhe dëmet sipas secilës klasë të sigurimeve.
4. Për secilin rast të marrëveshjes së risigurimit ku siguruesi është ceduesi dhe sipas të cilës risigurimi hyn në fuqi në datën e vlerësimit, për secilën klasë të biznesit:
- a) emrat e risiguresve me të cilët siguruesi ka arritur marrëveshjet e risigurimit;
 - b) nëse siguruesi dhe risiguresi janë të ndërlidhur dhe nëse po si janë të ndërlidhur;
 - c) një tregues të natyrës dhe shtrirjes së mbulesës së dhënë sipas marrëveshjes së risigurimit;
 - d) primet e pagueshme nga siguruesi sipas marrëveshjes së risigurimit në periudhën e llogaritjes të cilës i referohet raporti i vlerësimit;
 - e) shuma e depozituar në datën e vlerësimit në lidhje me marrëveshjen e risigurimit sipas çfarëdo marrëveshje për kthimin e depozitës;
 - f) pjesa e risigurimit në provizionet teknike që ndërlidhet me primet dhe dëmet sipas secilës klasë të risigurimit.
5. Të vlerësojë nëse asetet e investuara të siguresit që mbulojnë provizionet teknike janë në pajtim me legjislacionin aktual në fuqi për sigurime. Të tregohet në detaje lista e atyre aseteve të investuara.
6. Të vlerësojë nëse kapitali minimal i siguresit dhe margjina e solvencës janë në pajtim me legjislacionin aktual në fuqi për sigurime. Të tregohen rezultatet e kalkuluara të margjinës së solvencës dhe aseteve që mbulojnë kapitalin e kërkuar.

Neni 11

Sigurimi i jetës - përmbajta e detajuar e deklaratës të raportit të aktuarit

1. Deklarata e raportit të aktuarit për detyrimet e sigurimit të jetës për të cilat provizionet matematikore janë pjesë e tyre, duhet të përmbajë së paku informatat në vijim:
- a) vlerësimi i tyre nëse siguruesi mban shënime të duhura për kalkulimin e provizioneve teknike;
 - b) përshkrim të plotë i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të secilës kategori të kontratave të sigurimit të marra në sigurim nga siguruesi, përfshi këtu normën e primit, garancitë dhe opsionet apo çfarëdo detyrimi i mbetur nga kontratat e mëhershme.
 - c) principet e përgjithshme dhe metodat e adoptuara të vlerësimit, duke përcjellë:
 - i. nëse kanë dalë provizione negative dhe nëse janë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar se ato janë kthyer në zero;
 - ii. nëse janë bërë provizionime për bonuse, nëse po në çfarë shkalle;
 - iii. baza e provizioneve të bëra për çfarëdo mospërputhje në mes natyrës dhe termeve të aseteve të mbajtura dhe detyrimit të vlerësuar;
 - iv. aty ku metoda e neto primeve përdoret për kalkulimin e provizioneve matematikore, nëse dhe deri në çfarë mase është modifikuar metoda në fjalë;
 - v. baza e provizioneve të ndara për të gjithë garancitë dhe opsionet e përcaktuara nga kushtet e policës.
 - d) normat e interesit, tabelat e vdekshmërisë të përdorura në kalkulimin e primeve dhe në vlerësimin e provizioneve që dalin nga kategoritë e ndryshme të kontratave të sigurimit të jetës.

- e) për të gjitha kontratat e sigurimit të jetës, përveç kontratave ku rreziku i investimit bartet nga i siguruari:
 - i. proporcioni i bruto primeve të destinuara për shpenzime dhe profit për secilën kategori të kontratave të sigurimit;
 - ii. metodat përmes të cilave provizioni ndahet për shpenzime pasi që primet të jenë ndalur apo ku nuk ka prime të ardhshme të pagueshme;
 - f) në lidhje me të gjitha llojet e kontratave ku rreziku i investimeve bartet nga i siguruari:
 - i. të gjitha supozimet e bëra gjatë vlerësimit të detyrimeve të tilla të sigurimit;
 - ii. ku nuk janë ndarë provizione eksplicite për të mbuluar shpenzimet e ardhshme operative të siguresit, detajet mbi bazën e cila është përdorur në testimin e mjaftueshmërisë të provizioneve;
 - g) në lidhje me kontratat e sigurimit që i japin të drejtë policëmbajtësit pjesëmarrje në profit:
 - i. llogarinë e të hyrave për asetet që mbulojnë provizionet matematikore ku e drejta për të marrë pjesë të profitit është e varur nga performanca e aseteve që mbulojnë provizionet matematikore.
 - ii. principli dhe metoda e aplikuar në ndarjen e profitit, rritja dhe zvogëlimi në vlerën e aseteve të sjella në llogari; shpenzimet dhe çfarëdo tatimi mbi asetet që mbulojnë provizionet matematikore.
 - h) nëse ka ndonjë referencë për principet mbi të cilat bëhet shpërndarja e profitit në mes të policëmbajtësve dhe aksionarëve apo përshkrim të këtyre principeve.
 - i) detajet mbi bonuset e ndara në secilën kategori të kontratave, duke përshkruar bazën e kalkulimit dhe rrethanat e formën në të cilën këto bonuse janë të pagueshme.
 - j) tregimi i rezultateve nga testi i adekuatshmërisë së detyrime (LAT) sipas llojeve të kontratave;
2. Kalkulimet e ndara të provizioneve teknike për sigurimin shtesë të bërë nga siguresit e jetës, që në veçanti do të thotë, sigurim kundrejt lëndimit personal përfshi paaftësisë për punë, sigurimit kundrejt vdekjes që shkaktohet nga një aksident dhe sigurimi kundrejt invaliditetit që shkaktohet nga një aksident si dhe sigurimi kundrejt invaliditetit që shkaktohet nga një aksident ose sëmundje, ku këto lloje të ndryshme të sigurimeve bëhen si shtesë e sigurimit të jetës.
3. Për kontratat e sigurimit që janë ceduar te risiguresi sipas klasave të sigurimit:
- a) totali (agregati) i primeve të paguara nga siguresi sipas kontratës së risigurimit në vitin e llogaritur në të cilën është ndërlidhur raporti i aktuarit, nëse është e përshtatshme dhe totali i shumës së depozituar në datën e vlerësimit sipas çfarëdo marrëveshje për depozita bankare;
 - b) pjesa e risigurimit të provizioneve teknike që kanë të bëjnë me primet dhe dëmet sipas secilës klasë të sigurimit.
4. Për secilën marrëveshje të risigurimit, ku siguresi është ceduesi dhe sipas të cilës risigurimi është në fuqi në datën e vlerësimit, për secilën klasë të sigurimit:
- a) emrat e risiguresve me të cilët siguresi ka arritur marrëveshjet e risigurimit;
 - b) nëse siguresi dhe risiguresi janë të ndërlidhur në ndonjë mënyrë dhe nëse po si janë të ndërlidhur;
 - c) tregimi i natyrës dhe shtrirjes së mbulimit të ofruara sipas marrëveshjes së risigurimit;
 - d) primet e pagueshme nga siguresi sipas marrëveshjes së risigurimit në periudhën llogaritëse të cilës i referohet raporti i vlerësimit;

- e) vlera e depozituar në datën e vlerësimit në lidhje me marrëveshjen e risigurimit sipas çfarëdo marrëveshje për kthimin e depozitave;
 - f) pjesa e risigurimit në provizionet teknike që kanë të bëjnë me primet dhe dëmet sipas secilës klasë të sigurimit.
5. Të vlerësoj nëse asetet e investuara të siguresit që mbulojnë provizionet teknike janë në pajtim me rregullativën në fuqi për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike, si dhe të rendis në detaje listën e këtyre aseteve të investuara që mbulojnë provizionet teknike.
6. Të vlerësoj nëse kapitali minimal dhe margjina e solvencës së siguresit janë në pajtim me rregullativën në fuqi për kapitalin minimal dhe solvencën. Renditja e rezultateve të kalkuluara për margjinën e solvencës dhe aseteve që mbulojnë kapitalin e kërkuar.

Neni 12

Çështjet tjera të ndërlidhura me përmbledhjen e opinionit të aktuarit dhe deklaratën e raportit aktuarial

1. Opinioni aktuarial duhet të përfshijë sigurimin se raporti aktuarial dhe dokumentet e punës aktuariale që mbështesin opinionin aktuarial do të mbahen te siguresi dhe do të jenë në dispozicion për ekzaminim nga BQK-ja deri në shtatë (7) vite nga data e lëshimit të raportit. Raporti duhet të mbahet konfidencial dhe nuk shpaloset për publikun.
2. Raporti aktuarial duhet të jetë konsistent me dokumentacionin dhe kërkesat për zbulim sipas standardeve dhe principeve të pranura aktuariale. Raporti aktuarial duhet të përmbajë komponentët përshkrues dhe teknik. Komponenti përshkrues duhet të ofrojë detaje të mjaftueshme për të shpjeguar qartë për menaxhmentin e siguresit, bordin e drejtorëve, rregullatorin apo autoriteteve tjera, gjetjet, rekomandimet dhe përfundimet, si dhe rëndësinë e tyre. Komponenti teknik duhet të ofrojë dokumentacion të mjaftueshëm dhe shpalosje për ndonjë aktuar tjetër që punon në të njëjtën fushë për të vlerësuar punën e bërë. Ky komponent teknik duhet të tregojë analizat nga të dhënat bazike, p.sh., trekëndëshat e humbjeve, deri te përfundimi.
3. Raporti gjithashtu duhet të përfshijë:
 - a) përshkrim të marrëdhënies të aktuarit të emëruar me siguresin, me prezantim të qartë të rolit të aktuarit në këshillim të bordit të drejtorëve dhe/ose menaxhmentit në lidhje me provizionet e bartura. Raporti duhet të identifikojë si dhe kur aktuari i emëruar i prezanton analizat pranë Bordit të drejtorëve dhe kur është e vlefshme, pranë zyrtarëve të siguresit që janë përgjegjës për përcaktimin e provizioneve të bartura.
 - b) deklaratë se aktuari ka barazuar të dhënat me pasqyrën aktuale vjetore të siguresit. Në kuptime tjera, ekzaminimi i tyre ka përfshi shqyrtime të tilla të vlerësimeve dhe metodave aktuariale të përdorura dhe testet e tilla të kalkulimeve siç i kanë parë të domosdoshme.
 - c) deklaratë nga aktuari nëse është e përshtatshme “në krijimin e opinionit tim mbi dëmet dhe provizionet e dëmeve, jam mbështetur mbi të dhënat e përgatitura nga _____(emri, përkatësia dhe marrëdhënia me siguresin). Kam vlerësuar ato të dhëna për arsyeshmëri dhe konsistencë”.
 - d) nëse aktuari ka përdorur punën e një aktuari tjetër, ai duhet ta identifikojë aktuarin tjetër me emër si dhe t’i identifikojë lidhjet e këtij të fundit me siguresin.

4. Siguruesit që i kërkohet të ofrojë një opinion aktuarial duhet të kërkojë nga aktuari i tyre i emëruar që të njoftojë Bordin e drejtorëve apo komitetin e auditimit me shkrim brenda pesë (5) ditëve pune pas çfarëdo përcaktimi nga ana e aktuarit të emëruar se opinionin i dorëzuar në BQK ka qenë me gabime si rezultat i mbështetjes në të dhëna dhe informata të tjera (përveç vlerësimeve) të cilat, me datën e bilancit të gjendjes, kanë qenë të dhëna faktike të pasakta. Opinionin do të konsiderohet me gabime nëse opinionin nuk do të lëshohej ose do të ishte materialisht i ndryshëm nëse do të përdreshin të dhënat apo informata të tjera të sakta. Opinionin nuk do të konsiderohet se është me gabime nëse do të ishte materialisht i ndryshëm apo nuk do të publikohej vetëm për shkak se të dhënat apo informatat në lidhje me ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes apo për shkak se rezultatet aktuale dallojnë nga ato që janë projektuar.
5. Do të kërkohet njoftim për çfarëdo përcaktimi të tillë të bërë në mes të lëshimit të opinionit dhe datës së bilancit të gjendjes se do të lëshohet opinionin tjetër. Njoftimi duhet të përfshijë një përmbledhje të gjetjeve të tilla dhe opinionin e ndryshuar.
6. Siguruesi i cili njoftohet sipas paragrafëve paraprak do të përcjellë një kopje të përmbledhjes dhe opinionin e ndryshuar të BQK-ja brenda pesë (5) ditëve të punës pas pranimit të tij dhe do t'ia sigurojë aktuarit të emëruar i cili e bën njoftimin një kopje të përmbledhjes dhe opinionit të ndryshuar, që do t'i dorëzohet BQK-së. Nëse aktuari i emëruar dështon në pranimin e një kopjeje të tillë brenda pesë (5) ditëve të punës siç është cekur më lartë, atëherë aktuari i emëruar e njofton BQK-në brenda pesë (5) ditëve të punës se opinionin i dorëzuar më herët nuk duhet të merret për bazë apo ndonjë njoftim të tillë të ngjashëm.
7. Nëse aktuari i emëruar mëson se të dhënat apo informatat e tjera të cilat janë përdorur kanë qenë faktikisht të pasakta, por nuk mundet menjëherë të përcaktojë se çfarë, nëse duhet, ndryshime duhet të bëhen në opinionin e aktuarit, atëherë aktuari dhe siguruesi duhet të nisin procedurat, sa më shpejt që të jetë e arsyeshme në aspektin praktik, që nevojiten në mënyrë që aktuari të bëjë përcaktimin e diskutuar më lartë. Nëse siguruesi nuk i ofron përmirësimet e kërkuara të të dhënave dhe përkrahjen tjetër (përfshi financiare) brenda dhjetë (10) ditëve të punës, aktuari duhet të procedoj me njoftimin e diskutuar më lartë.
8. Aktuarët e emëruar nuk do të jenë përgjegjës në çfarëdo mënyre ndaj cilitdo person për çfarëdo deklarate të bërë në lidhje me paragrafët më lartë nëse deklarata e tillë është bërë me mirëbesim si përpjekje për të respektuar paragrafët më lartë.

Neni 13

Përmbajta e detajuar e përmbledhjes së opinionit aktuarial

1. Siguruesit duhet të dorëzojnë një dokument të emëruar Përmbledhja e Opinionit të Aktuarit (POA), ky dokument do të dorëzohet në BQK deri më 15 mars të çdo viti kalendarik ose ndonjë datë të mëvonshme të caktuar ndryshe nga BQK-ja.
2. POA duhet të jetë konsistente me praktikën dhe standardet adekuate aktuariale .
3. Përjashtimet nga dorëzimi i POA janë të njëjta si ato për dorëzimin e Deklaratës të Raportit Aktuarial.

4. POA duhet të nënshkruhet dhe të vendoset data nga aktuari i emëruar i cili ka nënshkruar deklaratën e raportit aktuarial. Paragrafi i OPINIONIT duhet të përfshijë një fjali që së paku mbulon pikat e renditura në ilustrimin e mëposhtëm:
- a) shënimet e duhura janë mbajtur nga siguruesi për qëllim të vlerësimit të detyrimeve të sigurimeve;
 - b) shuma e provizioneve teknike të ndara nga siguruesi përbëjnë provizionimin e duhur për detyrimet e siguruesit që dalin nga ose janë të lidhura me kontratat e sigurimeve;
 - c) provizionet teknike janë investuar në pajtim me rregullativën në fuqi për investimin e asetëve në mbulim të provizioneve teknike.
 - d) margjina e solvencës në dispozicion të siguruesit ka përmbushur marginën e kërkuar të solvencës ashtu siç është e definuar me rregullativën në fuqi për solvencën.
5. Një deklaratë e opinionit aktuarial duhet të bëhet në pajtim me njërën prej nën paragrafëve 1.1 deri 1.4 të këtij paragrafi . Aktuari duhet të identifikojë në mënyrë specifike se cilës kategori i takon:
- a) *Përcaktimi i provizioneve të arsyeshme.* Kur shuma e provizioneve teknike është brenda kufijve të aktuarit për vlerësime të arsyeshme të provizioneve, atëherë aktuari duhet të lëshoj një deklaratë të opinionit të aktuarit se shuma e provizioneve teknike është provizion i arsyeshëm për detyrimet e ndërlidhura me provizionet specifike.
 - b) *Përcaktimi i mungesës ose jo-mjaftueshmërisë së provizioneve.* Kur shuma e provizioneve teknike është më e vogël se shuma minimale të cilën aktuari mendon se është e arsyeshme, atëherë aktuari duhet të lëshoj një deklaratë të opinionit aktuarial se shuma e provizioneve teknike nuk duket se është provizion i arsyeshëm për detyrimet e ndërlidhura me provizionet specifike.
 - c) *Përcaktimi i provizioneve të tepërta ose jashtë mase.* Kur shuma e provizioneve teknike është më e madhe se sa shuma maksimale për të cilën aktuari mendon se është e arsyeshme, atëherë aktuari duhet të lëshojë një deklaratë të opinionit aktuarial se shuma e provizioneve teknike nuk duket se është provizion i arsyeshëm për detyrimet e ndërlidhura me provizionet specifike.
 - d) *Opinion i kualifikuar.* Kur, sipas opinionit të aktuarit, provizionet për ndonjë zë apo zëra të caktuar vihen në dyshim për shkak se nuk mund të vlerësohen arsyeshëm apo kur aktuari nuk është në gjendje që të jap opinion mbi këta zëra, aktuari duhet të lëshojë një deklaratë të kualifikuar të opinionit. Opinioni i tillë i kualifikuar duhet të tregoj nëse shuma e provizioneve teknike është provizion i arsyeshëm për detyrimet e ndërlidhura me provizionet specifike, përveç për zërin ose zërat, për të cilët vlen kualifikimi. Nuk kërkohet nga aktuari që të japë opinion të kualifikuar nëse mendon arsyeshëm se zëri ose zërat në fjalë nuk janë material.
 - e) *Pa opinion.* Aftësia e aktuarit për të dhënë opinionin varet nga të dhënat, analizat, vlerësimet dhe informatat e ndërlidhura të cilat do të ishin të mjaftueshme për të mbështetur një përfundim. Nëse aktuari nuk mund të arrijë në përfundim për shkak të mangësive ose kufizimeve në të dhëna, analiza, vlerësime ose informata të ndërlidhura, atëherë aktuari mund të lëshoj një deklaratë pa opinion. Deklarata pa opinion duhet të përfshijë përshkrimin e arsyeve pse nuk është dhënë opinionin.

6. Asnjë prej aktuarve të emëruar nuk do të jetë përgjegjës në çfarëdo mënyre ndaj cilitdo person për çfarëdo deklarate të bërë në lidhje me paragrafët më lartë nëse deklarata e tillë është bërë në mirëbesim si përpjekje për të përmbushur paragrafët më lartë.

7. Modeli i deklaratës së përmbledhjes së opinionit të aktuarit që duhet të përcillet.

“Kam ekzaminuar vlerësimet dhe metodat aktuariale të përdorura në përcaktimin e provizioneve teknike të ndara nga siguruesi me 31 dhjetor 20___, si dhe kam shqyrtuar informatat që më janë ofruar deri më datën XXX. Vlerësimi aktuarial është kryer në pajtim me ligjet, rregullat dhe rregulloret relevante aktuale të sigurimeve.

Detyra ime është verifikimi i mbajtjes adekuate të regjistrave nga ana e siguruesit për qëllim të vlerësimit të detyrimeve nga sigurimet. Provizionet adekuate teknike janë përgjegjësi e Bordit të drejtorëve të siguruesit; aktuari i emëruar duhet të shprehë opinionin mbi adekuatshmërinë e provizioneve teknike që kanë të bëjnë me detyrimet e siguruesit, që dalin nga ose që kanë të bëjnë me kontratat e sigurimeve dhe të verifikojnë përmbushjen e rregulloreve në fuqi.

Është detyrë e imja që të konfirmojë se provizionet teknike të paraqitura më lartë, bazuar në vlerësimet e arsyeshme aktuariale dhe duke marrë parasysh resurset e tjera financiare të siguruesit, që janë në dispozicion për këtë qëllim, janë të mjaftueshme për t’ia mundësuar siguruesit që të përmbushë zotimet e saj në lidhje me këto kontrata. Është gjithashtu detyrë e imja që të përcaktojë shumën minimale të kapitalit të siguruesit dhe shumën e margjinës së kërkuar të solvencës. Si dhe të verifikoj nëse asetet e investuara të siguruesit që mbulojnë provizionet teknike janë në pajtim me legjislacionin aktual në fuqi për sigurimet.

Jam i bindur se ekzaminimet e kryera aktuariale ofrojnë bazë të mjaftueshme për opinionin tim të mëposhtëm.

Sipas opinionit tim, shuma e provizioneve për primin e pafiturar në vitin financiar 20xx, si dhe shuma e provizioneve për dëme më 31 dhjetor 20xx janë të mjaftueshme për t’ia mundësuar siguruesit përmbushjen e zotimeve në lidhje me këto kontrata të sigurimeve.”

Nënshkrimi i aktuarit
Emri i shtypur i aktuarit
Emri i punëdhënësit
Adresa e aktuarit
Numri i telefonit të aktuarit
Posta elektronike e aktuarit
Data kur është dhënë opinionit

Neni 14

Kufizimet e aktivitetit të aktuarëve të aprovuar

1. Aktuarëve të aprovuar nuk iu lejohej që të kryejnë aktivitetet aktuariale për siguruesit nëse:
 - a) kanë aksione direkte ose indirekte në kapitalin e siguruesit;
 - b) janë anëtar ose të afërm të bordit të drejtorëve, menaxhmentit të lartë, si dhe anëtar të komisionit të auditimit apo funksionit të auditimit të brendshëm të siguruesit.

- c) janë duke vepruar në ndonjë kapacitet tjetër për siguruesin e që nuk janë aprovuar nga BQK-ja.
2. Siguruesit do të njoftojnë BQK-në për emërimin ose shkarkimin e aktuarit të emëruar brenda 8 ditëve kalendarik nga data e emërimit ose shkarkimit. Kur siguruesi ka për qëllim që të ndërrojë kompaninë aktuariale, siguruesi duhet të marrë aprovimin paraprak me shkrim nga BQK-ja. BQK-ja gjithashtu kërkon njoftim me shkrim nga aktuari i emëruar që zëvendësohet se zëvendësimi i tij nuk është bërë për shkak të çfarëdo mospajtimi me menaxhmentin e siguruesit në lidhje me kërkesat për zbulim ose raportim.
 3. Nëse siguruesit dështon që të ofrojnë një raport mbështetës aktuarial apo dokumentet e punës pas kërkesës nga BQK-ja, apo nëse BQK-ja përcakton se raporti mbështetës aktuarial apo dokumentet e punës të dorëzuara nga siguruesi nuk janë të plota apo të papranueshme për BQK-në, atëherë BQK-ja mund të angazhojë një aktuar tjetër të aprovuar me shpenzime të siguruesit për të shqyrtuar deklaratën e opinionit aktuarial dhe bazën për këtë deklaratë dhe të përgatitë raportin mbështetës aktuarial apo dokumentet e punës.
 4. Nëse siguruesi dështon të emëroj aktuarin e tij brenda dy muajve nga marrja e aprovimit të BQK-se për të njëjtin, apo nëse emëron një aktuar i cili nuk është aprovuar nga BQK-ja sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, BQK-ja do të emërojë një aktuar të aprovuar të kualifikuar dhe shpenzimet e emërimit do të barten nga siguruesi.
 5. Nëse çfarëdo aktuari i aprovuar e ndërpret aktivitetin e vet me një sigurues, duhet ta njoftojë BQK-në brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data e ndërprerjes.
 6. Nëse aktuari i aprovuar e ndërpret aktivitetin e vet me një sigurues, atëherë siguruesi do të emëroj një aktuar të aprovuar brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e ndërprerjes së aktivitetit të aktuarit të mëparshëm dhe do ta njoftojë BQK-në për këtë emërim të ri.

Neni 15

Shkeljet nga aktuari

1. BQK-ja mund të shqiptojë gjobë dhe masa të tjera administrative të parapara me ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për sigurimet, për një aktuar, për shkeljet si në vijim:
 - a) nuk i aplikon dispozitat në lidhje me kushtet e kontratës me siguruesit.
 - b) nuk vepron në pajtim me këtë rregullore dhe Ligjin për sigurime lidhur me kompletimin dhe dorëzimin e raportit aktuarial dhe opinionit të aktuarit.
 - c) nëse shkelin çfarëdo dispozite të kësaj rregulloreje.

Neni 16

Shtojcat

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është edhe aneksi 1 me tabelat e bashkëngjitura.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi nga data 1 prill 2016.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci

ANEKS I

Forma e raportimit të provizioneve teknike (jojetë)

Tabela A1. Struktura e provizioneve, primet e pafituara për periudhën: _____

Kodi	Klasat e sigurimit	Primi i shkruar	Provizionet për primin e pafituar (dhe provizionet për riskun e paskaduar)	Pjesa e risigurimit	Provizionet për primet e pafituara neto të risigurimit (4-5)
1	2	3	4	5	6
1	Aksidentet				-
2	Shëndetësi				-
3	Automjetet				-
4	Mjetet hekurudhore				-
5	Aeroplan				-
6	Anije				-
7	Mallrat në transport				-
8	Zjarri dhe fatkeqësitë				-
9	Dëmet tjera për pronë				-
10	Auto-përgjegjësia				-
	TPL				-
	TPL+				-
	Kufitare				-
	Fondi i kompensimit				-
11	Përgjegjësi nga fluturaket				-
12	Përgjegjësi nga anijet				-
13	Përgjegjësi e përgjithshme				-
14	Kredi				-
15	Garancionet				-
16	Humbje të ndryshme financiare				-
17	Shpenzimet ligjore				-
18	Asistencë				-
	Totali	-	-	-	-

Aktuari i autorizuar i kompanisë

(Emri dhe mbiemri, vula e kompanisë)

Vendi dhe data

Tabela A2. Struktura e provizioneve për dëme për periudhën:

Kodi	Klasat e sigurimit	Provizionet teknike për dëmet e raportuara	IBNR	Kostoja e rregullimit të dëmeve	Pjesa e risigurimit - RBNS	Pjesa e risigurimit - IBNR	Provizionet teknike për dëme, neto e risigurimit (3+4+5-6-7)
1	2	3	4	5	6	7	8
1	Aksidentet						
2	Shëndetësi						
3	Automjetet						
4	Mjetet hekurudhore						
5	Aeroplan						
6	Anije						
7	Mallrat në transport						
8	Zjarri dhe fatkeqësitë						
9	Dëmet tjera për pronë						
10	Autopërgjegjësia						
	TPL						
	TPL+						
	Kufitare						
	Fondi i kompensimit						
11	Përgjegjësi nga fluturaket						
12	Përgjegjësi nga anijet						
13	Përgjegjësi e përgjithshme						
14	Kredi						
15	Garancionet						
16	Humbje të ndryshme financiare						
17	Shpenzimet ligjore						
18	Asistencë						
	Totali						

Aktuari i autorizuar i kompanisë

(Emri dhe mbiemri, vula e kompanisë)

Vendi dhe data

Forma e raportimit të provizioneve teknike (life)

Tabela A3. Struktura e provizioneve, primet e pafituara për periudhën: _____

Kodi	Klasat e sigurimit	Primi i shkruar	Provizionet për primin e pafitur (dhe provizionet për riskun e paskaduar)	Pjesa e risigurimit	Provizionet për primet e pafituara neto të risigurimit (4-5)
1	2	3	4	5	6
1	Jetë				-
2	Martesë				-
3	Jetë grup				-
4	Anuitete				-
5	Jetë shtesë				-
	Totali	-	-	-	-

Tabela A4. Struktura e provizioneve për dëme për periudhën: _____

Kodi	Klasat e sigurimit	Provizionet teknike për dëmet e raportuara	IBNR	Kostoja e rregullimit të dëmeve	Pjesa e risigurimit - RBNS	Pjesa e risigurimit - IBNR	Provizionet teknike për dëme, neto e risigurimit (3+4+5-6-8)
1	2	3	4	5	6	7	8
1	Jetë						-
2	Martesë						-
3	Jetë grup						-
4	Anuitete						-
5	Jetë shtesë						-
	Totali	-	-	-	-		-

Aktuari i autorizuar i kompanisë

(Emri dhe mbiemri, vula e kompanisë)

Vendi dhe data

Tabela B1. Vlera e zhvillimit të humbjeve (Euro)

Viti i aksidentit	Dëmet e ndodhura (të paguara dhe të papaguara), vlerat bruto											
	Vitet e zhvillimit											
	-	1	2	3	4	5	6	7	8	>	Totali	
<												-
N-8												-
N-7												-
N-6												-
N-5												-
N-4												-
N-3												-
N-2												-
N-1												-
Viti aktual N												-

Tabela B2. Numri i zhvillimit të humbjeve.

Viti i aksidentit	Dëmet e ndodhura (të paguara dhe të papaguara), numri i dëmeve											
	Vitet e zhvillimit											
	-	1	2	3	4	5	6	7	8	>	Totali	
<												-
N-8												-
N-7												-
N-6												-
N-5												-
N-4												-
N-3												-
N-2												-
N-1												-
Viti aktual N												-

Viti i aksidentit	Dëmet e paguara, numri i dëmeve											
	Vitet e zhvillimit											
	-	1	2	3	4	5	6	7	8	>	Totali	
<												-
N-8												-
N-7												-
N-6												-
N-5												-
N-4												-
N-3												-
N-2												-
N-1												-
Viti aktual N												-

Trekëndëshat ndërtohen në mënyrë specifike për klasë të ndryshme të sigurimeve. Këto janë të detyrueshme për klasën e sigurimeve TPL dhe klasave të hyrat nga primi i të cilave tejkalon 10% të të ardhurave të përgjithshme vjetore nga primet.